

KONTRATË BINJAKËZIMI

Përkrahje për Statistikat

Kosovë



RAPORT MBI MISIONIN

**Aktiviteti 2.6.2: Vazhdim i përkrahjes në përpilimin e Llogarive Kombëtare
në Kosovë, me fokus në SUT**

Komponenti nr 2 Llogaritë Kombëtare

Misioni i udhëhequr nga
Søren Larsen dhe Jens Holst Jensen
Statistikat e Danimarkës

19-23 Tetor 2015

IPA 2012

Emri i autorit, adresa, e-mail

*Søren Larsen
Statistics Denmark
Sejrøgade 11
DK-2100 Copenhagen Ø
Denmark
Tel: +45 39 17 39 83
Email: shl@dst.dk*

*Jens Holst Jensen
Statistics Denmark
Sejrøgade 11
DK-2100 Copenhagen Ø
Denmark
Tel: +45 39 17 34 84
Email: jhj@dst.dk*

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive.....	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
1. Komentet e Përgjithshme	5
2. Vlerësimet dhe rezultatet.....	6
2.1 Kodimi i burimit të dhënave.....	6
2.2 Agrokultura.	6
2.3 Statistikat e TVSH.....	6
2.4 Statistikat e ASN-së për 2012.	6
2.5 Statistikat e ASN-së për 2013.	7
2.6 PRODCOM statistikat për 2014.....	7
2.7 Industritë që nuk janë të mbuluara nga ASN, TVSH ose PRODCOM.....	7
2.8 Krahësimi i strukturës së outputit dhe inputit.	7
2.9 Qeverisja e përgjithshme.....	7
2.10 Tregtia e jashtme e mallrave.	8
2.11 Tregtia e jashtme e shërbimeve.	8
2.12 Anketa e buxhetit të ekonomive familjare.	8
2.13 Korniza Excel për SUT 2013.	8
2.14 Marzhat e tregtisë dhe transportit.....	8
2.15 Taksat më pak të subvencionuara në produkte.....	8
2.16 TVSH.	8
2.17 Korniza SUT në rrjet.	9
3. Konkluzionet dhe rekomandimet.....	9
Aneksi 1. Termat e Referencës.....	11

Lista e Shkurtesave

CPA	Statistical Classification of Products by Activity in the European Economic Community
ABEF	Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
NACE	Nomenklatura e veprimtarive ekonomike
PRODCOM	Lista e Produkteve në Komunitetin Evropian
ASN	Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve
SUT	Tabelat Ofruese-Përdoruese
TeR	Termat e Referencës

Përmbledhje Ekzekutive

Qëllimi i këtij misioni ishte përgatitja e të dhënave statistikore për kornizën e SUT, në formatin Excel. Dimensionet dhe struktura e kornizës së tabelës është përcaktuar gjatë misionit të kaluar, por ka pasur nevojë për disa rregullime shtesë.

Për të qenë të përshtatshme për përdorim si inpute, secili burim i të dhënave duhet të konvertohet në klasifikime të produkteve, lloje të transaksionit, industri dhe grupe të konsumit, që përdoren në kornizën SUT. Përveç kësaj, të dhënat duhet të transferohen në tabela në formate të standardizuara, që mund të futet në kornizën e SUT, duke përdorur Excel macro ashtu që të gjitha vlerat vendosen në rreshtat/kolonat/shtresat e duhura të SUT.

Kjo punë ka filluar në dy misionet e mëhershme me burimet e të dhënave që kanë qenë në dispozicion në atë kohë. Outputet e bujqësisë, Konsumi i Ndërmjetëm i Qeverisë në Përgjithësi dhe Konsumi final i Ekonomive Familjare sipas anketës të buxhetit të ekonomive familjare janë koduar pak a shumë në tërësi para misionit, por kanë mbetur për tu zgjidhur edhe disa probleme. Statistikat për importin dhe eksportin e mallrave tani janë të gatshme për tu futur në kornizën SUT.

Statistikat e detajuara mbi TVSH-në për vitin 2013 duket që përmbajnë informata më të besueshme mbi outputin dhe inputin total sipas industrisë, për ato industri që mbledhin TVSH-në. Është konvertuar në total për industritë NACE2 dy shifror, që korrespondojnë me kolonat për prodhim dhe konsum të ndërmjetëm. Përveç kësaj, outputet e industrisë nga industritë NACE 4 shifror janë konvertuar në klasifikimin e produktit në SUT. Është e qartë, që kjo mënyrë primitive e distribuimit të outputeve të industrisë sipas produkteve duhet të zëvendësohet me struktura më të besueshme nga statistikat e bujqësisë-, ASN-ja dhe PRODCOM, kur ka të dhëna të tilla.

Eksperti danez ka transferuar outputin e ASN-së për vitin 2012 nga NACE1.1 në NACE2 dhe e ka koduar sipas produkteve në SUT. Në këtë mënyrë, struktura e produktit të outputit të industrisë mund të përdoret si shtesë, kur nuk ka informata të plota në statistikat e ASN-së për vitin 2013.

Para misionit aktual ka qenë e vështirë të kodohet ASN e vitit 2013 për shkak të mungesës së shpjegimeve. Gjatë misionit është shpjeguar kuptimi i kolonave në tabela dhe tani duhet të jetë e mundur t'u jepet të dhënave një formë e tillë, që mund të përdoret vendosjen e strukturave fillestare të produktit për secilën industri.

Statistikat PRODCOM për vitin 2014 supozohet të jenë burimi më i mirë i mundshëm i informacioneve mbi strukturat e produktit për outputet dhe inputet në industrinë e prodhimit. Anketa nuk ka qenë në dispozicion deri në fillim të Tetorit. Ne kemi menduar që është e përshtatshme të mos fillojë misioni aktual përpara se të jenë në dispozicion këto statistika. Tani është e mundur të kodohet outputi prej kësaj ankete. Inputi ende duhet të klasifikohet në mënyrë sistematike. Të gjitha përshkrimet e inputit janë në Gjuhën Shqipe; kodimi duhet të bëhet në bashkëpunim midis ekspertëve danezë dhe stafit të ASK-së.

Puna e papërfunduar mbi burimin e të dhënave duhet të vazhdojë në misionin e radhës, kur shpresojmë të arrijmë të përfundojmë kodimin dhe formatizimin. Po ashtu, duhet të jetë e mundur të bëjmë kalkulimet, që janë të nevojshme për përcaktimin e totalit të kolonave në SUT, që nënkupton outputin dhe importet sipas çmimeve bazike dhe konsumit të ndërmjetëm dhe konsumit final sipas kategorive, duke përfshirë eksportet sipas çmimit blerës.

Para misionit të radhës do të vendoset korniza qendrore e SUT në një server të rrjetit, ku mund të kenë qasje të gjithë personat, që punojnë në futjen e të dhënave.

Misioni i radhës planifikohet të mbahet në fund të Nëntorit ose në fillim të Dhejtorit.

1. Komentet e përgjithshme

Ky raport mbi misionin është përgatitur në kuadër të Projektit të Binjakëzimit 'Përkrahje për Statistikat'. Është misioni i tretë, që i kushtohet përpilimit të Tabelave Ofruese-Përdoruese për vitin 2013 në kuadër të komponentit 2 të projektit, Llogarive Kombëtare. Ky mision ka pasur për qëllim vazhdimin e punës në përgatitjen e të dhënave për tu përdorur si input në kornizën e tabelave ofruese përdoruese. Kjo punë ka filluar në misionin e kaluar. Një burim i rëndësishëm statistikor, statistikat e reja 'PRODCOM' nuk priteshin të jenë të gatshme deri në fund të Shtatorit.

Objektivat konkrete të misionit ishin:

- Të vazhdohet me kodimin dhe formatizimin e burimit të dhënave, që ka filluar në misionin e kaluar.
- Të analizohen dy burimet e reja të të dhënave 'ASN 2013' dhe 'PRODCOM 2014' dhe të përgatitet plani për shfrytëzimin e tyre në këtë projekt.
- Të vazhdohet zhvillimi i kornizës Excel i vendosur gjatë misioneve të kaluara.

Që nga misioni në Qershor, janë të gatshme burimet e të dhënave ka qenë për tregtinë e jashtme të mallrave, outputet dhe inputet e bujqësisë, tatimit mbi vlerën e shtuar sipas industrive, konsumi i ekonomive familjare dhe financat e qeverisë. Personat përgjegjës për secilën prej këtyre fushave kanë punuar në kodimin e këtyre burimeve të të dhënave sipas produkteve, industrive dhe grupit të konsumit të përdorur në kornizën SUT. Gjatë këtij misioni është punuar edhe në zgjidhjen e problemeve në kuadër të këtyre fushave. Si rezultat, janë krijuar një numër faqesh në Excel, të standardizuara, të gatshme për tu përdorur në kornizën e Excel-it.

Statistikat e ASN-së për vitin 2013 kanë qenë të gatshme gjatë misionit të mbajtur në Qershor, por në atë kohë ka qenë e vështirë të përdoren pasi përshkrimi i tyre nuk ka qenë tërësisht i përkthyer në Gjuhën Shqipe. Tani ato do të kthehen në një format të standardizuar dhe të koduar, para misionit të radhës. Mbulueshmëria është ende e kufizuar. Për të plotësuar zbrazëtitë e mundshme, statistikat e ASN-së për vitin 2012 janë koduar me klasifikimet e SUT për vitin 2013.

Statistikat e reja PRODCOM për vitin 2014 përmbajnë informata të vlefshme mbi kompozimin e outputeve dhe inputeve në industritë e prodhimit. Ana e outputi është koduar si produkt i Llogarive Kombëtare dhe do të kthehet në një formë të krahasueshme me të dhënat e ngjashme me ato të ASN-së ose TVSh-së.

Statistikat e TVSH-së mbi industritë NACE2 katër shifror duket të jenë burimi më i besueshëm për prodhimin, konsumin e ndërmjetëm dhe GFCF në shumë industri, por duhet të plotësohet me informata mbi prodhimin sekondar nga burime të tjera.

Është bërë një propozim i ri për orarin kohor të përpilimit të SUT. Pasi statistikat PRODCOM për vitin 2014 dhe versionin final i statistikave të ASN-së për vitin 2013 nuk kanë qenë të gatshme deri në mes të Shtatorit, misioni aktual është caktuar të mbahet në Tetor. Meqenëse misioni aktual është shtyrë deri në fund të Tetorit dhe divizioni i Llogarive Kombëtare në Prishtinë do të merret me publikimin në pjesën e parë të nëntorit, është propozuar që misioni i radhës të mos mbahet deri në fund të Nëntorit.

Konsulentët dëshirojnë të falënderojnë të gjithë zyrtarët dhe personat e takuar, për mbështetjen dhe informacionet e vlefshme që kanë dhënë, gjë që ka lehtësuar shumë punën e tyre gjatë qëndrimit në Kosovë.

Këndvështrimet dhe vëzhgimet e paraqitura në këtë raport janë ato të konsulentëve dhe jo domosdoshmërisht përputhen me këndvështrimet e BE-së, ASK-së apo Statistikave të Danimarkës dhe partneri jonë i implementimit (NI-CO / Statistikat e Finlandës / Istat / Statistikat e Lituanisë).

2. Vlerësimi dhe rezultatet

2.1 Kodimi i burimit të dhënave.

Ky mision kryesisht ju ka kushtuar kodimit të burimit të dhënave, disa prej të cilave kanë qenë të gatshme qysh në Mars ose Qershor, ndërsa të tjerat janë vënë në dispozicion të Llogarive Kombëtare tani.

2.2 Bujqësia.

Kodimi ka filluar gjatë fazës eksperimentale në misionin e mbajtur në Maj. Gjatë këtij misioni janë adresuar disa probleme të pazgjidhura. Krahasimi me të dhënat ekzistuese të Llogarive Kombëtare nxjerr në pah disa dallime, që duhet të shpjegohen më tej.

2.3 Statistikat e TVSH-së.

Këto statistika me sa duket përmbajnë informacionet më të mira në nivel të outputeve totale, inputeve dhe GVA-së për industrinë kryesore. Pasi që të gjitha variablat në industrinë NACE2 katër shifror janë në dispozicion, është e lehtë të krijohen totalët e TVSH-së për secilën industri NACE 2 shifror. Megjithatë, disa fusha nuk janë mirë të mbuluara me këto statistika, pasi disa industri nuk e mbledhin TVSH-në dhe me siguri nuk janë të përfshira në statistika. E njëjta vlen për aktivitetet e pa vrojtuar, që mund të kenë ndikim të madh në disa industri.

Shpërndarja sipas produkteve të outputeve të industrisë mundet po ashtu, si një zgjidhje e paracaktuar, të bazohet në outputet e nën-industrive 4 shifrore që janë të përfshira në secilën industri 2 shifrore. Një shpërndarje e tillë e outputit total sipas industrisë nga produktet e LLK tashmë është rregulluar dhe e gatshme të futet në kornizën Excel, por duhet të theksohet, që këto shpërndarje do të zëvendësohen aty ku ASN-ja ose PRODCOM konsiderohen si burime të fuqishme.

2.4 Statistikat ASN për vitin 2012.

Këto statistika fillimisht janë koduar nga NACE 1.1 e vjetër. Për të qenë të dobishme si plotësim i informacioneve mbi strukturat e outputit dhe inputit në industrinë NACE2, ato u ri-koduan. Pasi kodimi u bë sipas NACE katër shifror, nuk ishte shumë e vështirë të konvertohen shumica në NACE2 dy shifror kredibile. Tani janë në formën, që është e krahasueshme me të dhënat nga TVSH-ja, ASN-ja 2013 dhe PRODCOM.

2.5 Statistikat ASN për vitin 2013.

Këto statistika kanë qenë në dispozicion, me titujt e përkthyer nga Gjuha Shqipe në Gjuhën Angleze, para këtij misioni. Megjithatë, ka pasur nevojë për disa shpjegime lidhur me disa tituj. Tani duhet të jetë e mundur të konvertohen dhe përkthehen të dhënat në format, që mund të përdoret për krahasim me shifrat nga statistikat mbi TVSH-në 2013, ASN 2012 dhe PRODCOM. Kjo është planifikuar të realizohet nga eksperti Danez para misionit të ardhshëm. Mbulueshmëria e ASN-së për vitin 2013 thuhet se është e pamjaftueshme dhe me siguri duhet të plotësohet me statistikat mbi TVSH-në, ASN-në e vitit 2012 dhe PRODCOM 2014.

2.6 Statistikat PRODCOM për vitin 2014.

Këto statistika me siguri janë burimi më i mirë për shpërndarjet e outputeve dhe inputeve të industrive sipas produkteve në kuadër të secilës industri NACE2 dy shifror, edhe kur nuk i referohet në mënyrë rigorozë vitit 2012. Tashmë titujt janë edhe në gjuhën Angleze. Pasi kodimi i outputit përcjell standardin ndërkombëtar dhe mund të krijohen tabelat korrespondente midis PRODCOM 2014 dhe NACE, duhet të jetë relativisht lehtë të konvertohen të dhënat në klasifikimet e produktit, që përdoren në SUT, me Excel macro. Plani është që kjo të bëhet para misionit të ardhshëm.

Statistikat PRODCOM po ashtu përmbajnë informacione mbi strukturat e inputit të secilës industri. Këto informata nuk janë klasifikuar në mënyrë sistematike të njëjtë. Të dhënat duhet të kodohen duke shikuar përshkrimet e inputeve në Gjuhën Shqipe, detyrë e cila kërkon ende punë me stafin e ASK-së.

2.7 Industritë që nuk mbulohen nga ASN, TVSH ose PRODCOM

Një numër industrish dhe produktesh nuk do të mbulohen nga burime si statistikat e ASN, TVSH ose PRODCOM. Në këto raste detyra kryesore është të gjenden, rishikohen dhe zhvendosen shifrat prej Llogarive Kombëtare ekzistuese në formatin e duhur për SUT.

Gjatë misionit ne kemi shikuar kalkulimet e Shërbimeve Financiare, fondit të Sigurimeve dhe atij Pensional dhe kemi bërë kalkulimet e nevojshme për SUT. Ngjashëm, duhet të gjejmë kalkulimet për aktivitetin e marrjes së banesave me qera, çmimin e supozuar të qerasë, dhe disa aktiviteteve të tjera.

2.8 Krahasimi i strukturave të outputit dhe inputit.

Kur të jenë të gatshme statistikat e TVSH-së, statistikat e ASN-së për vitin 2012 dhe 2013 dhe PRODCOM për vitin 2014 në forma të krahasueshme, duhet të jetë e mundur të kombinohen tabelat e të dhënave si bazë për vendimet mbi strukturat e kolonave të cilat, do t'i përdorim si fillim për SUT, të pabalancuara.

2.9 Qeveria e përgjithshme

Informacionet nga llogaritë e qeverisë tani më përmbajnë një kodim sistematik të konsumit të ndërmjetëm qeveritar. Që nga misioni i kaluar është krijuar një korrespondencë midis këtij kodimi dhe klasifikimit të produktit të përdorur në SUT, dhe gjatë misionit aktual janë zgjidhur disa probleme të pazgjidhura. Kodimi i industrisë bazohet në kodimin-COG, që ka ekzistuar në burimin e të dhënave. Inputet tani janë konvertuar në formatin e nevojshëm për kornizën Excel. Pagat dhe mëditjet, kontributet sociale, taksat në të ardhurat nga shitjet, janë koduar sipas-ESA. Po ashtu, është në dispozicion vlerësimi i konsumit të kapitalit fiks, dhe do të duhej të ishte më e lehtë të kalkulohej vlerat e outputit të qeverisë sipas industrive. Megjithatë, është shumë e rëndësishme që këto shifra të krahasohen me shifrat e njejtë nga Llogaritë Kombëtare ekzistuese dhe të dhënat e publikuara nga Ministria e Financave, para se të konsiderohen si shifra finale.

2.10 Tregtia e jashtme e mallrave.

Këto shifra janë konvertuar nga HS në CPA dhe është krijuar korrespondenca midis mes kodimit original dhe kodimit të produktit, që përdoret në SUT. Importet dhe eksportet tani janë në formën e përshtatshme për tu futur në kornizën Excel.

2.11 Tregtia e jashtme e shërbimeve.

Para këtij misioni ka qenë në dispozicion një version më i zbërthyer nga balance i pagesave. Gjatë misionit aktual është përcaktuar madhësia e korrigjimit CIF-FOB. Kjo vlerë duhet të zbritet nga importi i transportit- dhe shërbimet e sigurimit, për të evituar numërimin e dyfishtë, pasi e njëjta vlerë përfshihet në importin e mallrave në Llogaritë Kombëtare.

2.12 Anketa e buxhetit të ekonomive familjare.

Kjo anektë është në dispozicion në Excel. Fillimisht është i koduar sipas një version të detajuar të COICOP, që duhet të përkthehet në kode të produkteve, që përdoret në SUT. Shumica e punës është bërë në ASK para misionit, kurse tani janë zgjidhur disa nga problemet e mbetura. Totalët në ABEF parimisht duhet të mbulojnë konsumin e ekonomive familjare të popullsisë së përgjithshme. Sipas ABEF, konsumi i ekonomive familjare është në mënyrë të konsiderueshme më i ulët se në Llogaritë Kombëtare aktuale, po ashtu në grupet COICOP, ku kjo nuk mund të shpjegohet me dallimet në koncepte. Tani po bëhet një analizë për të kuptuar shkaktarin e këtij ndryshimi.

2.13 Korniza Excel për SUT 2013.

Është bërë korrigjimi i kornizës “së zbrast” në Excel për SUT. Është bërë pastrimi i klasifikimit të produkteve për të evituar përsëritjen e produkteve, si dhe një numër rreshtash në sistem janë fshirë apo janë riemëruar.

2.14 Marzhat e tregtisë dhe transportit.

Vlerat e totale të marzhave të tregtisë – dhe transportit përcaktohen si vlerë e outputit total nga industria e tregtisë minus aksionet, që janë shpërndarë si burime sipas çmimit bazik. Shtresat e marzhës që përmbajnë formulat që përfaqësojnë një model të shpërndarjes të furnizimit me shumicë – dhe marzhave të tregtisë me pakicë duhet të finalizohen para datës të fillimit të misionit të ardhshëm.

2.15 Taksat minus subvencionet në produkte.

Kjo duhet të identifikohet për të gjitha produktet e taksueshme. Dogana dhe akciza janë paraqitur në statistikatat e tregtisë së jashtme për importet e shpërndarë sipas produkteve të tyre specifike. Taksat e tjera dhe subvencionet për secilin produkt duhet të gjenden në llogaritë qeveritare. Neto shtresa e taksave në anën përdoruese të SUT, përmban formulat që paraqesin një model të thjeshtë për shpërndarjen e taksave sipas përdorimit. Ndoshta nevojiten disa përshtatje me rregullat specifike të legjislacionit të Kosovës.

2.16 TVSH.

Në mënyrë të ngjashme, shtresa për TVSH në anën e përdorimit duhet të përmbajë formula, që përfaqësojnë legjislacionin për TVSH-në në Kosovë. Kalkulimi për TVSH-në që nuk zbritet për secilën qelizë në anën e përdorimit mund të shfrytëzojë informacionet mbi vlerësimin aktual të TVSH-së, sipas industrisë dhe qëllimit, që gjenden në statistikatat e TVSH-së; prandaj modeli i TVSH-së do të jetë disi më ndryshe nga ato të përdorura në vendet e tjera, që kanë pasur asistencën Daneze. Për momentin është duke u shqyrtuar një model specifik për TVSH-në e Kosovës.

2.17 Korniza SUT në rrjet.

Është planifikuar të ruhet “versioni aktual” i Excelit për SUT – në serverin e rrjetit, ku do të ketë qasje nga kompjuterët e stafit, që punojnë me të dhënat në fusha të ndryshme, që do të futen në sistem. Serveri duhet të përmbajë po ashtu versionin më të ri të atyre materialeve , që përbëjnë inpute të standardizuara.

3. Konkluzionet dhe rekomandimet

Burimet e të dhënave, që kanë qenë në dispozicion gjatë misionit të kaluar, tani janë koduar dhe janë të gatshme të futen në kornizën e SUT. Megjithatë, ende ka nevojë të krahasohen rezultatet me shifrat ekzistuese nga Llogaritë Kombëtare, dhe të analizohet nëse mbulueshmëria është e mjaftueshme. Kjo është në veçanti e rëndësishme për outputin dhe inputin e bujqësisë dhe për vlerësimin e konsumit të ekonomive familjare, bazuar në anketën e buxhetit të ekonomive familjare.

Burimet e të dhënave, që kanë qenë të gatshme pak para fillimit të misionit aktual, duhet të konvertohen në formë të njëjtë. Kjo është bërë për outputet e industrisë, bazuar në statistikën e TVSH-së dhe strukturat e outputit-2012 bazuar në statistikën e ASN-së për këtë vit. Kodimi i strukturave të outputit në statistikën PRODCOM për vitin 2014 dhe produktet SUT janë realizuar gjatë këtij misioni, por ana e inputit do të kërkojë punë shtesë nga stafi i ASK-së dhe me siguri do të kërkojë, që një pjesë e kohës ti dedikohet kësaj detyre edhe gjatë misionit të ardhshëm, pasi përshkrimet e produktit janë vetëm në Gjuhën Shqipe. Të dhënat nga ASN-ja për vitin 2013 ende nuk janë transformuar në formatin e standardizuar. Ekspertët Danezë do të punojnë në këtë çështje, që me siguri më së miri mund të kryhet nga macros Excel.

Para misionit të ardhshëm korniza e SUT dhe hapësira për inputet duhet të vendoset në serverin e rrjetit dhe personat, që do të punojnë në SUT, të kenë të drejtën e qasjes në dosjet. Po ashtu, rekomandohet që të caktohet një person përgjegjës për mirëmbajtjen e këtyre dosjeve.

Gjatë këtij misioni është paraqitur një shembull i kornizës Excel, që mund të përdoret për përshkrimin sistematik të hapave të përfshirë në kalkulimet fillestare të totaleve të kolonave në anën ofruese, në çmime bazike, dhe përdorimit sipas çmimit blerës. Në misionin e radhës në këtë kornizë do të futen së bashku të dhënat nga burime të ndryshme. Dë të duhen të merren vendime për qëllimet/caqet ashtu që strukturat e outputit dhe inputit, nga burime të ndryshme, të vendosen së bashku në tabela, ku mund të krahasohen.

Plani më poshtë duhet të konsiderohet si draft pasi është e vështirë të vlerësohet koha e duhur për secilën detyrë. Pasi misioni aktual është shtyrë për disa javë, misioni i ardhshëm do të duhet të mbahet në fund të Nëntorit për të pasur kohë të mjaftueshme për të planifikuar punën midis misioneve. Duke pasë parasysh kohëzgjatjen e projektit, duhet të planifikojmë një numër misionesh në Dhjetor, Janar dhe Shkurt për të kompensuar vonesat. Kjo duhet të diskutohet në misionet e ardhshme.

Veprimi	Afati kohor	Personat përgjegjës
Validimi i inputeve të dhënave që janë koduar: Bujqësia Inputi dhe outputi i Qeverisë Konsumi i Ekonomive familjare	Në fillim të misionit të radhës	ASK:
Kodimi i burimeve të të dhënave shtesë për outputet: Statistikat e TVSH-së ASN 2013 PRODCOM 2014	Para misionit të radhës Para misionit të radhës Gjatë misionit të radhës	Ekspertët Danezë “ “ ASK dhe ekspertët
Strukturat e inputit: ASN 2013 PRODCOM	Do të filloj para misionit të radhës Gjatë misionit të radhës	Ekspertët Danezë ASK

Aneksi 1. Termat e Referencës



Projekti i Binjakëzimit i BE-së

KS12 IB ST 01

Përkrahja për Statistika

Komponenti 2: Llogaritë Kombëtare

Aktiviteti 2.6.2: Vazhdim i përkrahjes në përpilimin e llogarive kombëtare në Kosovë, me fokus në SUT

Orari:

TeR –data e përgatitjes: 2 Tetor 2015

Fillimi / fundi i aktivitetit: 19-23 Tetor 2015

Koha e raportimit: 30 Tetor 2015

Rezultatet obligative të komponentit:

Rezultati obligativ	Intervenimi logjik	Pikë referimi	Burimi i informacionit	Sugjerimet
2.3.1	Përkrahje në implementimin e Planit të Veprimit për Llogaritë Kombëtare Vazhdim i përkrahjes në implementimin e Planit të Veprimit për Llogaritë Kombëtare Përkrahja finale në implementimin e Planit të Veprimit për Llogaritë Kombëtare	- Raportet e misioneve, të publikuar në faqen e internetit të projektit - Fushat e caktuara të Llogarive Kombëtare, të përditësuara sipas ESA2010	- Raportet tremujore të projektit të Binjakëzimit - Raporti i Misionit - Plani i veprimit, i përditësuar	- Kapacitet i mjaftueshëm i absorbimit - Numër i vogël i stafit i involvuar në implementim - Stafi punon në realizimin e dytrave, që lidhen me projektin në mes të misioneve - Qasje në statistikat primare të sakta - Termat e referencës, të përpiluara me kohë, që paraqesin në detaje detyrat, rezultatet e pritura, pjesëmarrësit në aktivitet dhe agjendën

Subjekti / qëllimi i aktivitetit: 2.6.2

Përkrahja në përpilimin e Llogarive Kombëtare në Kosovë. Fokus në Tabelat ofruese-përdoruese (SUT). Ky mision është vazhdimësi e misionit me Z. Søren Larsen 2.6.1 në Qershor të vitit 2015. Misioni në Qershor ka konkluduar që:

Pasi burimet e të dhënave nga ASN dhe PRODCOM nuk do të jenë të gatshme deri në mes të Shtatorit 2015, ana ofruese e SUT nuk duhet të përfundojë deri sa këto burime të rëndësishme të jenë në dispozicion. Për më tepër, është e rëndësishme që stafi në ASK të ketë kohën e nevojshme për të përfunduar detyrat e tyre. Në fillim të misionit të ardhshëm, të dhënat e anës ofruese duhet të vendosen së bashku dhe të gjitha duhet të sillen në një formë të standardizuar, të gatshme për tu futur në kornizën Excel.

Plani për misionet mbi SUT është rishikuar në Qershor:

	Koha	Çështjet më të rëndësishme
1	Mars 09-13, 2015	Misioni i gjetjes së fakteve
2	Qershor 22-26, 2015	Klasifikimet, tabelat korresponduese dhe kodimi i burimit të të dhënave (ky mision)
3	Në fillim të Tetorit 2015 (Ky mision)	Oferta sipas industrisë dhe produkteve. Futja e të dhënave, distribuimi i taksave, marzhat e tregtisë dhe transportit.
4	Në fillim të Nëntorit 2015	Balancimi i anës ofruese dhe përdoruese për secilin produkt.
5	Në fund të Nëntorit ose në fillim të Dhjetorit 2015	Përshtatjet për inputet e industrisë dhe përdorimet finale
6	Në mes ose në fund të Janarit 2016	Balancimi final i marzhave, taksave dhe TVSH, ndarja e GVA, tabela simetrike I-O.
7	Shkurt 2016	Çështjet e pazgjidhura. Prezantimi i versionit final të rezultateve. Propozimet për punën në të ardhmen.

Rezultatet e pritura nga aktiviteti 2.6.2:

Raporti i misionit, që përshkruan rezultatet e kodimit të dhënave, që do të përdoren për SUT

Rekomandimet për SUT në të ardhmen në ASK

Përshkrim i punës së bërë gjatë misionit dhe punës që duhet bërë para fillimit të aktivitetit të radhës

Stafi i ASK-së:

Xhevdie Fetahu, Shefe e Divizionit të Llogarive Kombëtare, Xhevdie.Fetahu@rksgov.net

Ylli Shala, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Ylli.Shala@rks-gov.net

Ilir Mazrekaj, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Ilir.Mazrekaj@rks-gov.net

Emine Bajrami, Zyrtare e lartë e Llogarive Kombëtare, Emine.Bajrami@rks-gov.net

Florije Krapa, Zyrtare e lartë e Llogarive Kombëtare, Florije.Krapa@rks-gov.net,

Nysret Sylejmani, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Nysret.Sylejmani@rks-gov.net

Besim Mehmeti, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Besim.Mehmeti@rks-gov.net

Ilir.T. Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare, Ilir.T.Berisha@rks-gov.net

Ekspertët e vendeve anëtare:

Z. Søren Larsen, Ekspert i LLK, Statistikat e Danimarkës, shl@dst.dk

Z. Jens Holst Jensen, Këshilltar i Lartë, jhj@dst.dk

Stafi i Projektit të Binjakëzimit:

Z. Per Knudsen, RTA, pkn@dst.dk

Znj. Nora Zogaj, asistente e RTA, nzogaj@yahoo.com

Përshkrimi i historikut për aktivitetet

Raporti i Vlerësimit të Adaptuar Global i vitit 2012 (AGA), i përgatitur nga Eurostat-i, deklaron në lidhje me Llogaritë Kombëtare (f. 53-54): Në vitin 2010, ASK-ja, me mbështetjen e IPA-s, ka përgatitur një 'Plan të veprimit për përpilimin dhe publikimin e statistikave gjithëpërshirëse për llogaritë kombëtare dhe tregun e punës'. Ky plan është në parim një instrument i dobishëm për organizimin dhe zhvillimin e ardhshëm të Llogarive Kombëtare, së bashku me zhvillimin e standardeve dhe burimeve, që janë të nevojshme për rritjen e mbulueshmërisë dhe përmirësimin e të dhënave të llogarive kombëtare.

Projekti i Binjakëzimit deri tani ka pasur disa aktivitete në Komponentin #2 Llogaritë Kombëtare përfshirë misionin e gjetjes së fakteve mbi SUT.

Gjatë misionit të gjetjes së fakteve, ASK dhe eksperti kanë gjetur që është e mundur të krijohet SUT për Llogaritë Kombëtare në Kosovë.

Aktivitetet, që duhet të ndërmerren në përgatitje të misionit:

- Raportet e misioneve të kaluara në komponentin e LLK. Të gjitha të publikuara në www.dst.dk/kosovo

Aktivitetet e pritura janë:

- Azhurnimi i planit të veprimit për përmirësimin e Llogarive Kombëtare me SUT
- Zhvillimi i planit të detajuar për veprimet e ardhshme mbi SUT nga programi i binjakëzimit
- Kodimi i të dhënave

Rezultatet e pritura janë:

- Raporti i misionit – sipas modelit
- Plani i detajuar për aktivitetet e mëtejme në komponentin 2 nga programi i binjakëzimit
- Versioni i azhurnuar i planit për SUT
- Lista e veprimeve që duhet të ndërmerren para misionit të ardhshëm

Aneksi 1. Programi, Tetor 2015

Dita	Vendi	Koha	Ngjarja
1	ASK	10:00	ASK: Rishikim i punës së bërë nga misioni i kaluar mbi LLK në Nëntor 2014
		10:45	Pushim për kafe
		11:00	Diskutimi mbi planet për këtë javë
		12:00	Dreka
		13:30-15:30	Punë praktike në të dhënat SUT
2	ASK	09:00-16:00	Punë praktike në të dhënat SUT
3	ASK	09:00-16:00	Punë praktike në të dhënat SUT
4	ASK	09:00-16:00	Punë praktike në të dhënat SUT Diskutimi mbi rekomandimet Plani për misionin e ardhshëm dhe sit ë veprohet para misionit të radhës Shkrimi i raportit
5	ASK	10:00-12:00	Shkrimi i raportit Takim mes ekspertëve, udhëheqësit të komponentit dhe RTA. (RTA është në DK për takime dhe në pushim vjetor)